

VENDIM
Nr. 719, datë 31.10.2014

PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E AGJENCISË PËR ZHVILLIM
BUJQËSOR DHE RURAL¹

(Ndryshuar me VKM nr. 877 datë 14.12.2016)

(I përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 10, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, të nenit 6, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, dhe të nenit 21, të ligjit nr. 9817, datë 22.10.2007, “Për bujqësinë dhe zhvillimin rural”, me propozimin e ministrit të Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural, si agjencia e pagesave, në kuptim të nenit 21, të ligjit nr. 9817, datë 22.10.2007, “Për bujqësinë dhe zhvillimin rural”, është person juridik publik në varësi të ministrit të Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave.

2. Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural e ka selinë në Tiranë dhe ushtron veprimtarinë e saj në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

3. Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural ofron shërbime të drejtpërdrejta për fermerët vendas dhe zbaton politikat shtetërore për zhvillimin bujqësor dhe rural në Republikën e Shqipërisë.

4. Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural është përgjegjëse për administrimin e fondeve të programeve për bujqësinë dhe për zhvillimin rural, si më poshtë vijon:

- a) Fondeve të buxhetit të shtetit;
- b) Fondeve kundërparti, të projektit 2KR;
- c) Fondeve të Bashkimit Evropian;
- ç) Fondeve të siguruara nga shtete apo organizma të tjerë me qëllim zhvillimin bujqësor e rural në Shqipëri.

5. Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural ka për detyrë:

a) të vërë në zbatim masat e politikave bujqësore dhe të zhvillimit rural, si dhe masa të tjera të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore, nëpërmjet:

i) ofrimit të shërbimeve ndihmëse për fermerët dhe shoqëritë e bashkëpunimit bujqësor që ushtrojnë veprimtarinë në Republikën e Shqipërisë, në seli dhe në terren;

ii) orientimit të veprimtarisë së fermerëve në përputhje me drejtimitet e përcaktuara nga Këshilli i Ministrave dhe Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave;

iii) zhvillimit të procedurave konkurruese për fermerët dhe mbështetjes së drejtpërdrejtë të tyre me subvencione të ndryshme;

b) të hartojë raportet dhe analizat, në përputhje me zhvillimin e bujqësisë;

c) të organizojë ngritjen dhe funksionimin e sistemeve të integruara të administrimit dhe të kontrollit;

ç) të krijojë dhe të mirëmbajë bazën e të dhënave të nevojshme;

¹ VKM 719 datë 31.10.2014 është botuar në Fletoren Zyrtare nr.180/2014.

VKM 877 datë 14.12.2016 është botuar në Fletoren Zyrtare nr.247/2016.

d) të zbatojë masat e kontrollit dhe auditit të brendshëm;
dh) të organizojë ngritjen dhe zbatimin e sistemeve të informimit të tregut;
e) të inspektojë fermerët dhe subjektet, që kanë përfituar nga fondet e programeve për zhvillimin bujqësor dhe rural.

6. Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural harton dhe ndjek planin e veprimit për përafrimin e strukturës organizative dhe të kapaciteteve të saj menaxhuese dhe teknike me standardet e akreditimit të Bashkimit Evropian.

7. Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural drejtohet nga drejtori i Përgjithshëm, i cili përfaqëson agjencinë, si dhe organizon e drejton të gjithë veprimtarinë e saj.

8. *Shfuqizuar.*

9. *Marrëdhëniet e punës së nëpunësve të AZHBR-së rregullohen në bazë të legjislacionit për nëpunësin civil. Marrëdhëniet e punës së punonjësve administrativë të AZHBR-së rregullohen në bazë të dispozitave të Kodit të Punës.*

10. Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural, e krijuar me vendimin nr. 1443, datë 31.10.2008, të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural (AZHBR), si agjenci e pagesave”, vazhdon funksionimin e saj me miratimin e këtij vendimi.

11. Struktura dhe organika e Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural, miratuar me urdhrin nr. 67, datë 13.2.2014, të Kryeministrit, mbeten në fuqi deri në miratimin e strukturës dhe organikës së re me urdhër të Kryeministrit, sipas organizimit të miratuar me këtë vendim.

12. Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural, i emëruar sipas vendimit nr. 1443, datë 31.10.2008, të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural (AZHBR), si agjenci e pagesave”, vazhdon detyrën me miratimin e këtij vendimi.

13. Rregullat dhe procedurat e funksionimit të brendshëm të Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural, si dhe ndarja e detyrave, përgjegjësive dhe kompetencave, ndërmjet saj e drejtorive të bujqësisë dhe institucioneve të tjera përcaktohen me udhëzim të ministrit të Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave.

14. Vendimi nr. 1443, datë 31.10.2008, i Këshillit të Ministrave, “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural (AZHBR), si agjenci e pagesave”, shfuqizohet.

15. *Shfuqizohet.*

16. Ngarkohet Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave për zbatimin e këtij vendimi.

17. *Për nëpunësit aktualë të AZHBR-së zbatohen dispozitat e nenit 67, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar.*

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama